



**Datë: 27.03.2018**

Duke u bazuar në Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Administrata Tatimore e Kosovës shpall:

## **KONKURS TË JASHTËM**

**Titulli i pozitës:** Zyrtar i Depos 1 (1 pozitë)

**Nr. i referencës së pozitës së punës:** AD/630/JP00031934

**Përgjegjësi mbikqyrëse:** Jo

**Raportimi:** Udhëheqësit të Div. të Koordinimit

**Pozita:** Pozitë e karrierës

**Orari i plotë i punës:** Po

**Kohëzgjatja e emërimit,** sipas LSHC, duke përfshirë periudhën e punës provuese 1 vjeçare.

**Koeficienti:** Shtatë(7) plus shtesa e aplikuesahme

**Vendi i punës:** Drejtoria e Përgjithshme

---

### **Qëllimi i vendit të punës:**

Zyrtar i Depos është përgjegjës për mirëmbajtjen e Depos Qendrore të Administratës Tatimore të Kosovës, respektivisht bënë administrimin e të gjithë mallrave që hyjnë dhe dalin nga Depoja brenda ATK-së.

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Për çdo hyrje të mallit mban bazën e të dhënave me kartelë të posaçme sipas gjendjes materiale dhe financiare ndërsa me rastin e daljes së materialit aplikon procedurat mbi pranimin dhe dorëzimin e materialit shpenzues apo inventarit sipas kërkesës së aprovuar me dokumentin përkatës;
- Mban azhuret të përhershëm të gjendjes së mallrave dhe sipas nevojës përgatitë raporte për hyrjen dhe daljen e mallrave të menaxherit;
- Bënë pranimin dhe depozitimin e mallrave të cilët janë të nevojshëm për Administratën Tatimore të Kosovës (pjesët rezervë të automjeteve, materialit për zyre, pajisjeve të vjetruara apo përkohësisht të papërdorshme, inventari e ri apo të demoluara, dhe formave të ndryshme tatimore etj.);
- Përgatitë raporte dhe planifikon shitjen e mallrave të cilat dalin jashtë përdorimit sipas kërkesave dhe nevojave duke u bazuar në procedurat ligjore.
- Askush nuk ka të drejtë dhe qasje në depo pa prezencën e zyrtarit të depos kurse prezencën e të tjerëve shënohet në librin e prezantuesëve që mbahet në depo;
- Rreptësisht ndalohet dhënia e çfarëdo informate kurdo qoftë pa pëlqimin e menaxherit lidhur me gjendjen e mallrave në depo;
- Kryen edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesës që momenti i imponon.

## **Kërkesat/Kualifikimet Profesionale:**

Që të kryej këtë punë me sukses, një individ duhet të ketë:

- Diplomë universitare drejtimi Ekonomik apo Biznesi me zero(0) përvojë pune ose Shkolla e Lartë me 2 vite përvojë pune pas diplomimit;
- Aftësi komunikuese dhe të jetë i gatshëm për punë në grup;
- Të ketë aftësi përdorimi të kompjuterit, së paku të programeve Word, Excel dhe qasje në Internet;
- Aftësi të mira komunikimi me shkrim dhe në folur të gjuhëve që aplikohen në Kosovë do të ishte përparësi.
- Të mos ketë dosje penale (të vërtetuar me certifikatë nga gjykata kompetente);

## **Paraqitja e kërkesave:**

*Aplikacionet mund të merren në Drejtorinë e Përgjithshme të Administratës Tatimore të Kosovës, e cila gjendet në adresën: Këndi i rrugëve "Bill Clinton" dhe "Dëshmorët e Kombit" p.n. në Prishtinë ose në web-faqen e Administratës Tatimore të Kosovës: [www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org) tek rubrika e punësimit.*

*Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopje të dëshmive të kërkuara sipas Shpalljes për rekrutim dorëzohen në Drejtorinë e Përgjithshme të ATK-së- në Prishtinë në Zyrën e Burimeve Njerëzore.*

*Aplikacionit duhet bashkëngjitur të dhënat biografike për përvojën paraprake dhe të gjitha kopjet e kualifikimeve. Vetëm aplikacionet zyrtare të Administratës Tatimore do të pranohen.*

***Njoftimi do të jete i hapur për dorëzimin e aplikacioneve 15 dite nga dita e publikimit , duke filluar nga data 27.03.2018 deri me datën 10.04.2018, që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit.***

*Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha Komunitetet në Kosovë.*

*"Komunitet jo- shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".*

*Kerkesat e derguara pas dates se fundit nuk do te pranohen. Kerkesat e pakompletuara do te refuzohen.*

*Per shkak te numrit te madh te kerkesave te pranuar, vetem kandidatet e perzgjedhur ne listen e ngushte do te kontaktohen.*

*Per informata shtese mund te kontaktoni ne numrin e tel. 038/200 25022 .*